

VENDIM
Nr. 247, datë 7.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU KORÇË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;

Denar Biba: zv.kryetar;

Bledar Skënderi: anëtar;

Edlira Jorgaqi: anëtare;

Rezarta Bitri: anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Klevis Fahri Balliu.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.0=2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Korçë, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, janë numri rendor 1 (një) znj. Valentina Pandi Duka, numri rendor 2 (dy) z. Ervin Bujar Salianji, numri rendor 3 (tre) z. Hekuran Bujar Hoxhalli, numri rendor 4 (katër) z. Klevis Fahri Balliu.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumëmemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku

Korçë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Korçë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 9 (nëntë), 11 (njëmbëdhjetë), 5 (pesë), 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 74, vendimin nr. 81, datë 20.3.2019, vendimin nr. 97, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 62, datë 12.3.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Ligoraj Jorgji Karamelo, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Ervin Bujar Salianji.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Korçë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 7 (shtatë), 8 (tetë), 10 (dhjetë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 129, datë 9.4.2019, vendimin nr. 147, datë 11.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 136 datë 9.4.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Arlind Engjell Çaçani, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Valentina Pandi Duka.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 208, datë 25.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 179, datë 18.4.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Andi Petraq Përmeti, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Hekuran Bujar Hoxhalli.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 14 (katërmëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalía e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 14 (katërmëdhjetë), z. Koçi Tahir Tahiri.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2575 prot., datë 26.4.2019, z. Koçi Tahir Tahiri, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Koçi Tahir Tahiri, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 26.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2145, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Koçi Tahir Tahiri, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2579 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2580 prot., datë 27.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Koçi Tahir Tahiri.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1267/1 prot., datë 30.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Koçi Tahir Tahiri, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Koçi Tahir Tahiri, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumëmemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Korçë, i renditur me numër rendor 14 (katërmbëdhjetë), z. Koçi Tahir Tahiri.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, z. Koçi Tahir Tahiri.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri